

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi	Programi Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës	Menaxhimi i ndryshimeve
Niveli	Bachelor
Statusi i lëndës	Obligative
Viti i studimeve	III
Semestri	V
Numri orëve në javë	3
Vlera në kredi - ECTS	5
Koha / lokacioni	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës	
Detajet kontaktuese	
Përshkrimi i lëndës	Lënda "Menaxhimi i Ndryshimeve" ka për qëllim t'u ofrojë studentëve njohuri themelore dhe praktike mbi procesin e ndryshimeve në organizata. Gjatë këtij kursi, studentët do të mësojnë rreth koncepteve kyçe të ndryshimeve organizative, arsyet për ndryshim, rezistenca ndaj ndryshimeve, roli i udhëheqjes dhe komunikimit në menaxhimin e ndryshimeve, si dhe strategjitë dhe modelet e implementimit të suksesshëm të tyre. Lënda kombinon teori bashkëkohore me analiza të rasteve studimore dhe ushtrime praktike, duke ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësi për të identifikuar nevojën për ndryshim, për të menaxhuar rezistencën dhe për të udhëhequr procese transformuese në mjedise të ndryshme organizative.
Qëllimet e lëndës	Përmbajtja e lëndës përfshin kundërshtime ndaj nocioneve mbizotëruese të ndryshimit në organizata si përgjigje ndaj mjediseve në ndryshim, të udhëhequra dhe zbatuara nga menaxhmenti i lartë, duke prezantuar teori, modele dhe koncepte mbi format e reja dhe inovative të organizimit për ndryshim. Ndryshimi në kontekstet organizative elaborohet më tej në lidhje me rolin thelbësor të udhëheqjes dhe kulturës në krijimin e organizatave të orientuara drejt ndryshimit. Përvoja e studentëve me ndryshimin dhe organizatat shërben si bazë për një diskutim reflektiv dhe kritik rreth qasjeve të shumta ndaj ndryshimit në organizata.

Rezultatet e pritura të mësim nxënies	Pas përfundimit të suksesshëm të modulit, studenti duhet të: 1. Përvetësojë njohuri bazë mbi menaxhimin e ndryshimit në ndërmarrje, (ECTS 0.5) , 2. Kuptojë rëndësinë e ndryshimeve pozitive në mbështetjen e performancës pozitive të biznesit, (ECTS 0.5) , 3. Identifikojë llojet e ndryshimeve brenda një ndërmarrjeje, (ECTS 0.7) , 4. Analizojë ndikimin e menaxhimit të ndryshimeve në operacionet e biznesit dhe ta dallojë atë nga llojet e tjera të menaxhimit, (ECTS 0.7) , 5. Zotërojë aftësi për të shqyrtuar tiparet e stileve të ndryshme të menaxhimit të ndryshimeve, (ECTS 0.8) , 6. Zhvillojë njohuri rreth teorive dhe praktikave të ndryshme të modeleve të menaxhimit të ndryshimeve, (ECTS 0.8) , 7. Zbatojë, së bashku me ekipin në ndërmarrje, menaxhimin dinamik të ndryshimeve në Transformimin Digjital. (ECTS 1) ,		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren			
Kollokuime – seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			35
Përgatitja përfundimtare në provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	3	2	6
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			125

Metodologjia e mësimdhënies (dhe mësimnxënies)	Ligjërata interaktive me studente lidhur me temat e ligjëruara, orientimi në shtjellimin e materialit duke marrë raste studimi të cilat do të diskutohen në grup, mësimi duke u bazuar në një problem të paraqitur, prezantimi në gupe nga studentet dhe luajtja e roleve, mësimet praktike për lëndën dhe angazhim për studentin për të prezantuar njohuritë e fituara gjatë ligjëratës. Ligjëratat organizohen sipas parimit prezantim të koncepteve teorike me power point , diskutime dhe prezantime të studentëve dhe studimeve të rastit. Studentëve do t'u jipen artikuj ose punime të zgjedhura për lexim dhe diskutim në ligjërata dhe ushtrime.
Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në bazë të të cilave do të ndërtohet nota përfundimare: ◆ Aktivitete dhe Angazhim në mësim max 10 pikë (%), ◆ Hartimi dhe prezantimi i projektit/punim seminarik max 30 pikë (%), ◆ Provimi final max 60 pikë (%), Kriteret e kalueshmërisë nderlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 10 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme: • Aktiviteti në mësim (5 pikë) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. • Angazhimi (5 pikë) - nënkupton që studenti të kryejë dhe prezantoj detyrat që caktohen në fund të secilës ligjërata dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese. Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulën e lëndës. 2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminarik - vlerësohet me 30 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme, Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studentëve – jo më shumë se 2 studentë) duhet të përgatit një projekt/punim seminarik (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta. Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plot me lëndën. Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

	Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari			
	Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari			
	Komponenti		Pikët (%)	
	Struktura dhe Qëllimi i punimit		10	
	Përmbajtja/shtjellimi i punimit		10	
	Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit		10	
	Gjithsej:		30	
	Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulën e lëndës Menaxhimi i Ndryshimeve.			
	3. Testi i provimit final, vlerësohet me 60 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,			
	Studenti ka të drejt ti nënshtrohet provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuar nga senati i Universitetit.			
	Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:			
	pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës 30 pikë (%) pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjësuar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit 30 pikë (%)			
	Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike.			
	Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit,			
	Notat në UShAF:			
	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi
	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm
	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm
8	C	70 - 79	Shumë mirë	
7	D	60 – 69	Mirë	
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm	
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi Tabela inteligjente, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori,			

	PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve online për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	60% teori; 40% praktikë; Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave në lëndën 'Menaxhim i Ndryshimeve' dhe aplikimit të tyre në aspektin praktik. Përmes këtij studimi synohet që studentët të fitojnë një kuptim më të qartë se si menaxhohen projektet në jetën reale, duke përdorur mjete dhe metoda të standardizuara. Nga gjithsej 125 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 60% teori – 40% praktikë: ➤ 75 orë - janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të menaxhimit të projekteve. ➤ 50 orë - janë të fokusuara në ushtrime praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektesh simulimi. Ndarja e ECTS sipas raportit 60%-40% Lënda 'Menaxhim i Ndryshimeve' vlerësohet me 5 ECTS, nga të cilat: ✓ 3.0 ECTS i dedikohen pjesës teorike. ✓ 2.0 ECTS i dedikohen pjesës praktike. Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.
Literatura	
Literatura bazë	1. Thomas Lauer, 2021, Change Management: Fundamentals and Success Factors, Springer Nature, Berlin 2. S.K. Bhatia, Management of Change and Organisational Development: Innovative Strategies and Approaches, Deep & Deep Publications, 2015 2. Kavitha Singh, Organisational Change and Development, Excel Books, 2015 3. Bughin, J., Seong, J., Manyika, J., Chui, M., & Joshi, R. (2018). <i>Notes from the AI Frontier: Modeling the Impact of AI on the World Economy.</i> McKinsey Global Institute
Literatura shtesë	1. Kotter, J. P. & Cohen, D. S. (2002). The heart of change: Real life stories of how people change their organizations. Boston MA: Harvard Business School Publishing Deep Publications, 2015 2. Kavitha Singh, Organisational Change and Development, Excel Books, 2015
*Informacione shtesë Përditësimi i përmbajtjes me bazë kërkimore	*Përmbajtja e lëndës është përditësuar për të reflektuar kontributet e punimit shkencor: Krasniqi, S., Haliti, L. R., & Mehmeti, I. (2022). Ttiulli: "Implementing organizational ethics as a change process in banks: A case study Bank for Business". Bussecon Review of Social Sciences (2687-2285), 4(1), 11–22. https://doi.org/10.36096/brss.v4i1.328 Ky punim është integruar në temën: "Ndryshimi organizativ dhe etika institucionale në organizata

	financiare” Arsyetimi për përfshirje: ○ Punimi paraqet një rast konkret të menaxhimit të ndryshimeve përmes implementimit të etikës organizative në një bankë në Kosovë. ○ Analiza empirike ndihmon studentët të kuptojnë lidhjen mes vlerave etike dhe proceseve të ndryshimit në një organizatë reale. Elementet e integruara në lëndë: * Rast studimi i përdorur gjatë javës 4: Zbatimi i etikës si katalizator i ndryshimeve organizative * Detyrë me shkrim: Analizoni rolin e etikës në suksesin e ndryshimeve në institucione financiare. * Diskutim në klasë: Faktorët që ndihmojnë ose pengojnë ndryshimet etike në banka.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndës, Roli dhe kuptimi i menaxhimit të ndryshimeve në organizatë - Njoftimi me syllabus-in dhe rezultatet e të nxënit - Rëndësia e ndryshimeve në organizatë - Sfidat e ambientit modern dhe nevoja për ndryshim - Roli i menaxhimit të ndryshimeve në suksesin organizativ Rezultatet e Nxënies që mbështet nr. 1,2
Java e dytë	Definimi i menaxhimit të ndryshimeve, efektet në organizatë dhe ndikimi i faktorëve psikologjik - Përkufizimi i menaxhimit të ndryshimeve - Pse ndodhin ndryshimet? - Reagimet psikologjike ndaj ndryshimeve - Rezistenca ndaj ndryshimeve dhe mënyrat e tejkalimit Rezultatet e Nxënies që mbështet nr.1,2,5
Java e tretë	Llojet e ndryshimeve në ndërmarrje/organizatë - Ndryshime të planifikuara vs. emergjente - Ndryshime strukturore, teknologjike, kulturore, procesuale - Shembuj praktikë të ndryshimeve në sektorë të ndryshëm Rezultatet e Nxënies nr.3
Java e katërt	Tema e ligjërates nga Punimi Shkencorë: “Ndryshimi organizativ dhe etika institucionale në organizata financiare” Procesi i ndryshimeve në ndërmarrje - Faza e analizës së situatës - Identifikimi i nevojës për ndryshim - Përgatitja dhe planifikimi për ndryshim - Përcaktimi i objektivave dhe indikatorëve Rezultatet e Nxënies nr. 3,5
Java e pestë	Teknikat e gjenerimit të ideve kreative për ndryshim - Brainstorming dhe teknikë Delphi - Analiza SWOT për ndryshim - Teknikat “Six Thinking Hats”, - Roli i kreativitetit në përgatitjen për ndryshim Rezultatet e Nxënies nr. 2, 4
Java e gjashtë	Procesi i menaxhimit me ndryshimet - Modelet klasike: Lewin (Unfreeze–Change–Refreeze), Kotter (8

	Steps) - Komunikimi gjatë ndryshimit - Pjesëmarrja e punonjësve në proces - Monitorimi dhe përshtatja e ndryshimeve Rezultatet e Nxënies nr. 4,5,7
Java e shtatë	Dy qasje të ndryshme për ndryshim Teoria E dhe Teoria O - Parimet e Teorisë E (efikasiteti ekonomik) dhe Teorisë O (organizimi dhe kultura) - Qasjet krahasuese dhe kombinimi i tyre - Shembuj nga praktika Rezultatet e Nxënies nr. 5,7
Java e tetë	Konceptet dhe qasjet e menaxhimit me ndryshimet - Qasjet evolucionare vs. revolucionare - Qasje sistemore dhe të qëndrueshme - Ndikimi i modelit të udhëheqjes në qasjet e ndryshimit Rezultatet e Nxënies nr. 6,7
Java e nëntë	Ndryshimet individuale, grupore/ekipore, organizative dhe strategjike - Niveli individual: motivimi dhe perceptimi - Niveli grupor: dinamika e ekipeve - Niveli organizativ: transformimi - Niveli strategjik: përshtatja me tregun Rezultatet e Nxënies nr. 3,4,5
Java e dhjetë	Strategjitë dhe taktikat e menaxhimit me ndryshimet - Strategjitë e përfshirjes, negociimit, manipulimit, detyrimit - Taktikat e komunikimit dhe mbështetjes - Zgjedhja e strategjisë në bazë të kontekstit organizativ Rezultatet e Nxënies nr. 5,6,7
Java e njëmbëdhjetë	Përgjegjësia shoqërore gjatë menaxhimit me ndryshimet - Ndikimi i ndryshimeve në komunitet dhe palët e interesit - Transparenca dhe etika në vendime - CSR gjatë ndryshimeve organizative Rezultatet e Nxënies nr. 2,5
Java e dymbëdhjetë	Kultura, politika dhe lidhësi i ndryshimeve në organizata - Roli i kulturës organizative si mbështetje ose pengesë - Politikat e brendshme dhe fuqia në organizatë - Llojet e lidhësit dhe ndikimi i tyre në ndryshim Rezultatet e Nxënies nr. 6,7
Java e trembëdhjetë	Menaxhimi korporativ i ndryshimeve - Perspektiva e bordit dhe menaxhmentit të lartë - Kontrolli dhe menaxhimi i rrezikut - Ndërlidhja ndërmjet strategjisë dhe ndryshimit Rezultatet e Nxënies nr. 5,6
Java e katërbëdhjetë	Problemet e tanishme të menaxhimit të ndryshimeve në epokën e transformimit dixhital dhe aplikimit të AI - Sfidat e reja nga AI, transformimi dixhital - Automatizimi dhe ndikimi në strukturat e punës - Ndryshimi i kompetencave dhe strukturave - Shembuj të ndërmarrjeve që kanë dështuar / pasur sukses në kohë digjitale Rezultatet e Nxënies nr. 5,7
Java e pesëmbëdhjetë	Prezantimi i punimeve seminarike - Prezantimi i projekteve dhe analizës së rasteve konkrete - Reflektim mbi procesin e ndryshimit - Vlerësimi dhe diskutimi grupor mbi rezultatet

	Rezultatet e Nxënies nr. 4,5,6,7
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte nda j kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësimmhënësi ka të drejtë t'i kërkoj studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	